

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

4000

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692035383

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

hr@infosoftoffice.al

E-mail

administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/06/13

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-07760-06-03-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

22729430

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/07/04

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2024/07/04

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/83994/06032024

22900000-9

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”; VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e DPA-së” I ndryshuar me VKM nr. 331, datë 22.05.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.360, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullores Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së përgjithshme të Arkivave ”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsytet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër □

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Më datë 04.06.2024, në sistemin elektronik të prokurimeve (app.gov.al) të Agjencisë së Prokurimit Publik, është shpallur nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a “Procedura e hapur mbi kufirin e Lartë monetar” me objekt: “Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave”, me fond limit 22,729,430 (njëzet e dy milion e shtatëqind njëzet e nëntë mijë e katërqind tridhjetë) lekë pa TVSH ose 225,356.2 (dyqind e njëzet e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) euro pa tvsh, me REF-07760-06-03-2024.

I- Në Shtojcën 5 (FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE) të DT-së, janë përcaktuar specifikimet teknike si më poshtë:

[?]

II-Specifikimet teknike të materialeve të arkivës Loti i Dyte:

1. Kuti kartoni 40 x 28 x 18 cm. Materiali qe do te perdoret do te jete karton i ngurte me permasa 78x109, I paprere, me peshe 2000 gr/m2. Do te kete dy kapake, te gjitha kendet do te jene 90 grade, te gjitha brinjet do te lidhen me beze. Kjo veshje behet per te siguruar ngjitjen. Kutia te jete me supriner 80 gr/m2 me ngjyre. Vendoset edhe nje lidhese per terheqje.
2. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 37x26 cm me llape 18 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje, me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. 0
3. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 33x25.5 cm me llape 10 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 3)
4. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 22x32 cm me llape 9 cm me dy llapa te palosura dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 4)
5. Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve ne arkive me leter kimike 1,2 me nurmer serie, blloqe me 100 flete, ne format A4, me logon e OSHEE Group.
6. Regjister dhenie- marrje dokumentashne format A3, me leter 80 gr/m2me logon e OSHEE Group.
7. Etiketa per kuti per arkiven qendrore (formati 14x19 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.

8. Etiketa per kuti per arkiven e rretheve (formati 14x9 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.
9. Formular dorezim materialesh ne arkive me leter 80 gr offset, format A4 me logon e OSHEE Group me 5C + llak.
10. Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave me format 25x35 cm. Faqet e brendshme me leter offset 80 gr/m2. me 200 faqe, me qepje me pe. Te shtypet ne format 50x70 ose 70x100 ku te formohet fashikulli me 8 faqe ose me 16 faqe ne menyre qe te realizohet qepja. Kapaku te behet me punim special me karton 1500 gr/m2, me qafallare dhe me fjongo. Kapaku te mbeshtillet me suprine me leter 170 gr/m2 e cila te jete e shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + boje special pantone orange 021C ose ekuivalent) + llak.
11. Fletehyrje e perkohshme ne arkive (format A4 me leter 80 gr/m2 e ndare ne mes, me birosje, blloqe me 100 flete)me logon e OSHEE Group.
12. Kuti me lidhese me karton 700 gr/m2 me lidhese me suprine me beze me shpine 10 cm me permasa 23x33.
13. Fletepalosje A4 me leter 170 gr/m2te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).
14. Fletepalosje 20x21 leter 170 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).
15. Postera 40x58 me leter adezive 200 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).
16. Postera 50x70 me leter adezive 200 gr/m2 m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).
17. Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18- Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramatur 620 gr/m2 që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
18. Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9- Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramatur 620 gr/m2 që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
19. Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37xx26 – Kartoni të jetë 330 gr/m2, me 2

krahë, krahët të brendashkruar të palosura 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura?

Per efekt ilustrimi per secilin artikull vendosen pamjet/skicat perkatese, te cilat do ti gjeni bashkelidhur.[?.]

II- Në Shtojcën 7(FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT) të DT-së, ndër të tjera janë përcaktuar:

[...]

2.4.1. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit si më poshtë:

ISO 16245 ose ekuivalent (per prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me baze celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë. Kjo të vërtetohet me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si edhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit

2.4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

?Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha

?Makinë qepse me pe me permasa 35x25

?Makinë prerje me permasa 80x110

?Makine qepese me tel

?Thikë një anëshe

- Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.

- Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqese kontraten e qirase ose huaperdorjes te lidhur mes paleve, me afat kohezgjatje minimalisht dy muaj vlefshmeri, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësine e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji)....

2.4.7 Ne daten dhe oren e hapjes se tenderit duhet te paraqitet ne cilesine e mostres:

? Nje Kutë per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18;

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Shoqëria “Infosoft Office” SHPK, si një kompani e fushës dhe e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, pasi u njoh me dokumentat e tenderit, vlerëson se, dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi nuk janë hartuar në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe për pasojë një pjesë e tyre duhet të ndryshohen.

Për këto arsye, mbështetur në pikën 1 të nenin 110 (Afatet për ankim) të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "...1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë?.", brenda afatit ligjor, po ju paraqesim ankesën si më poshtë vijon:

I- Në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike të artikujve të përcaktuar në Shtojcën 5 (FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE) të DT-së po ju praqesim kundërshtërshtimet tona si më poshtë vijon:

SË PARI:

Paraprakisht po ju sjellim në vëmendje se, procedura e prokurimit objekt I këtij ankimi, është pjesë e procedurës së prokurimit me objekt: "Shtypshkrime dhe materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a" e ndarë në dy lote, ku Loti i parë është me objekt: "Shtypshkrime për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave" dhe Loti i dytë është me objekt: "Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave";

Në listën e mallrave të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të kësaj procedure prokurimi janë përcaktuar ndër të tjera edhe artikuj e emërtuar si më poshtë:

Artikulli me numrin rendor 17 me specifikimet teknike: "Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18- Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramatur 620 gr/m2 që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura"

Artikulli me numrin rendor 18 me specifikimet teknike: "Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9- Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramatur 620 gr/m2 që të lejojë valzueshmërinë. Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të mbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura".

Artikulli me numrin rendor 18 me specifikimet teknike: "Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37xx26 – Kartoni të jetë 330 gr/m2, me 2 krahë, krahët të brendashkruar të palosura 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapur".

Përfshirja e artikujve të dosjeve dhe kutive per ruajtje të përherëshme në këtë procedurë prokurimi është në shkelje të akteve ligjore në fuqi e konkretisht me:

Nenin 15 të ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "PËR ARKIVAT" në të cilin përcaktohet:

[?1. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave harton normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor dhe organizon, drejton e kontrollon zbatimin e njësuar të saj në veprimtarinë e të gjithë rrjetit arkivor të vendit.

2. Për krijimin e normës tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit, Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave mbështetet në legjisllacionin e vendit dhe në aktet e marrëveshjet themelore ndërkombëtare, të pranuar në rang ndërkombëtar, në këtë ligj dhe në Rregulloren e

Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila miratohet nga Këshilli I Ministrave.

3. Rregullat e miratuara prej kësaj drejtorie, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji, janë të detyrueshme për zbatim në të gjithë rrjetin arkivor të vendit...].

Me vendimin Nr.360 datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullores Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave e ndryshuar me VKM nr. 331, datë 22.05.2019 e konkretisht me dispozitat e përcaktuara në:

- shkronjat l, ll e m të nenit 4 të kësaj VKM-je ku në mënyrë të qartë thuhet:

Funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka këto funksione:

?

l) Kryen blerjen e përqendruar për kutitë dhe dosjet për ruajtje të përhershme në çastin që fondkrijuesit kërkojnë të dorëzojnë dokumentet RHK pranë arkivave jo në veprim. Marrja në dorëzim nga autoritetet kontraktore bëhet vetëm pas verifikimit të parametrave të cilësisë nga punonjësit e specializuar të fushës së kimisë/restaurimit dhe arkivistikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit nga fondkrijuesit i bëhet menjëherë e ditur Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nga arkivi jo në veprim, së bashku me sasinë e kutive e të dosjeve, të përlllogaritura pas kontrollit të kryer nga arkivi jo në veprim, dhe shërben si nisje e procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;

ll) Kryen blerjen e përqendruar për kutitë dhe dosjet për ruajtje të përhershme për institucionet që kanë arkiva jo në veprim, për tipologjinë dhe institucionet e miratuara nga Këshilli i Lartë i Arkivave, sipas shkronjës f, të nenit 8, të kësaj rregulloreje, si dhe për materialet speciale të restaurimit të letrës. Marrja në dorëzim nga autoritetet kontraktore bëhet vetëm pas verifikimit të parametrave të cilësisë nga punonjësit e specializuar të fushës së kimisë/restaurimit dhe arkivistikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;

m) Procedura e prokurimit zhvillohet në fund të çdo viti, për vitin pasardhës, në bazë të totalit të sasive dhe fondit limit, të kërkuara për vitin pasardhës nga autoritetet kontraktore, të përcaktuara në shkronjën ll, të këtij neni, të cilat janë të detyruara t'ia përcjellin Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, së bashku me përlllogaritjen e sasisë e të fondit limit të fondkrijuesve, që pritet të dorëzojnë gjatë vitit pasardhës, jo më vonë se data 15 shtator e çdo viti. Çmimi për njësi për përlllogaritjen e fondit limit u bëhet i ditur institucioneve të përmendura në këtë shkronjë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, jo më vonë se data 31 gusht e çdo viti, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik?."

-

- në shkronjat e); ë) dhe f) të pikën 5 të nenit 8 të kësaj VKM-je ku përcaktohet:

[?5. KLA-ja miraton, paraprakisht:

?

e) Miraton standardet e kutive, të dosjeve dhe mjeteve kancelarike, që ndikojnë te cilësia dhe jetëgjatësia e dokumentit, të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë;

ë) Miraton standardet e kutive e të dosjeve për ruajtje të përhershme për arkivat jo në veprim dhe për institucionet që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre;

f) Përcakton institucionet dhe tipologjinë e dokumenteve të institucioneve, që janë të detyruara të zbatojnë standardin e shkronjës ë, të pikës 5, të këtij neni;?]

Pra referuar sa më sipër, autoriteti kontraktor për sa kohë në dokumentat e tenderit ka kërkuar të prokurojë artikujt e dosjeve dhe kutive për ruajtje të përhershme, atëherë ai jo vetëm është i

detyruar të përdorë në arkivat e tij, dosje dhe kuti sipas standarteve të miratura nga Këshilli i Lartë e Arkivave, por mbi të gjitha ky autoritet nuk mund të realizojë vetë, procedurat e prokurimit për këto lloje artikujsh pasi kjo vjen në kundërshtim të hapur me vendimin Nr.360 datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullores Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave e ndryshuar me VKM nr. 331, datë 22.05.2019, në të cilin në mënyrë të qartë është e përcaktuar që autoriteti i vetëm i autorizuar nga Këshilli I Ministrave është Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, e cila është epërcaktuar organ qendror blerës për prokurimin e këtyre llojve artikujsh.

Veprimet e autoritetit kontraktor, sa më sipër duke prokuruar vetë artikujt me numrat rendore 17; 18 dhe 19 të përcaktuara në shtojcën 5 të DT-së vjen në kundërshtim të hapur me pikën 1 të Nenit 21 (Autoriteti ose enti kontraktor) të LPP-së, ku përcaktohet:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj?”

Komisioni i Prokurimit Publik në raste të ngjashme kur autoritetet kontraktore kanë zhvilluar vetë procedurat e prokurimit për mallra apo shërbime për të cilat Organ qendror Blerës ka qënë i caktuar me VKM një tjetër autoritet kontraktor ka mbajtur qëndrimin që në të tilla raste procedura e prokurimit duhet të anulohet.

Në vendimin Nr. 851 /2023, date 04.09.2023, Komisioni I Prokurimit Publik ka arsyetuar si më poshtë vijon:

III.1.18. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar informacionit të autoritetit kontraktor, dërguar me anë të shkresës 863/4 prot, datë 25.08.2023, protokolluar me tonën me nr.2027/4, datë 29.08.2023, konstaton, se Urdhri i Prokurimit, i nxjerrë nga organi publik autoriteti kontraktor (Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier), që ka iniciuar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, mban Nr.5, datë 13.07.2023, ndërkohë që Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 09.06.2022, është publikuar në Fletoren Zyrtare më datë 13.06.2022, ç’ka nënkupton se referuar nenit 117, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare” në pikën 3 të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 393 datë 09.06.2022 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara dhe Ngarkimin e kësaj Agjencie për Kryerjen e Procedurave të Veçanta të Prokurimit Publik, në Emër dhe për Llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë”, parashikohet se “Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në mirëpërdorimin e fondeve publike, nëpërmjet kryerjes së procedurave të përqendruara të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla. ASHPP-ja zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave e shërbimeve në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës”. Ndërsa në pikën 1 gërma “n” të kreut III “Kryerja e Procedurave të Veçanta të Prokurimit Publik”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 393 datë 09.06.2022, parashikohet se: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, për prokurimin e fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve, si më poshtë vijon:

n) blerje pajisjesh laboratorike, si dhe mjetesh didaktike, të lidhura me proceset e tyre të punës, me përjashtim të atyre mjekësore;

Duke marrë shkas nga 13 interpretimi i dispozitave të sipërcituara vendimi i autoritetit kontraktor për nxjerrjen e Urdhrit të Prokurimit Nr. 5, datë 13.07.2023, “Mjete Didaktike mësimore” është një akt administrativ në kuptim të nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (ligji 44/2015), si “çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në momentin e nxjerrjes së aktit administrativ, Urdhrit të Prokurimit Nr. 5, datë 13.07.2023, “Mjete Didaktike mësimore”, për realizimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimim nuk ka qenë kompetencë e këtij organi publik, pasi Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 09.06.2022, është publikuar në Fletoren Zyrtare më datë 13.06.2022, ç’ka nënkupton, se referuar nenit 117 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”, konstatohet, se akti administrativ Urdhri i Prokurimit Nr. 5, datë 13.07.2023, është nxjerrë pas botimit në fletoren zyrtare të VKM nr. 393, datë 09.06.2022, dhe për rrjedhojë ky akt administrativ, pra Urdhri i Prokurimit Nr. 5, datë 13.07.2023 nuk është i ligjshëm në kuptim të nenit 107 “Ligjshmëria e aktit administrativ” të ligjit nr. Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet shprehimisht se: “Akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi”, pasi referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 393 datë 09.06.2022 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara dhe Ngarkimin e kësaj Agjencie për Kryerjen e Procedurave të Veçanta të Prokurimit Publik, në Emër dhe për Llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë” në pikën 1 gërma “n” të kreut III është përcaktuar se: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, për prokurimin e fondeve buxhetore zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve, ndër të tjera edhe për blerje pajisjesh laboratorike, si dhe mjetesh didaktike, të lidhura me proceset e tyre të punës, me përjashtim të atyre mjekësore. Në këtë VKM nuk është parashikuar në asnjë dispozitë kalimtare, që ky autoritet, pra Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, t’i delegojë kompetencë autoriteteve të tjera kontraktore për kryerjen e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Përjashtime në këtë VKM bëjnë vetëm rastet e cituara në pikën 2 të kreut III. Në nenin 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj”.

Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet, se “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse 14 vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat

juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest). Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm, konkretisht të Urdhrit të Prokurimit Nr. 5, datë 13.07.2023 “Mjete didaktike mësimore”, dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, konstaton se akti administrativ i sipërcituar i organit publik Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier për kryerjen e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet, se “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se veprimet e ndërmarra nga ky organ publik (autoriteti kontraktor) për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur, se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret, parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese Inter Allia në vendimin 15/2010 ka theksuar se “parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative.

Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore”. Sa më sipër, KPP-ja konstaton, se vendimi administrativ për nxjerrjen e Urdhrit të Prokurimit nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, më datë 12.07.2023, si një akt administrativ, i shtrin efektet mbi palët pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi. Ndaj KPP, gjykon, se ky vendim është marrë në kundërshtim me VKM nr. 393 datë 09.06.2022 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara dhe Ngarkimin e kësaj Agjencie për Kryerjen e Procedurave të Veçanta të 15 Prokurimit Publik, në Emër dhe për Llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë” dhe në tejkalim të kompetencave të organit publik dhe si i tillë është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK qëndron?”

SË DYTI:

Për të gjithë artikujt e përfshirë në këtë procedurë prokurimi, parametrat janë fikse dhe nuk është vendosur asnjë marzh në plus apo minus në raport me parametrat e vendosuar për artikujt nga AK-ja, pra kufijtë brenda të cilave lejohen plus dhe minus, përse i përket parametrave të përmasave dhe të peshës.

Në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike të artikujve objekt i këtij prokurimi nga AK-ja në

procesverbalin e hartimit të dokumentave nuk është dhënë asnjë argument në lidhje me hartimin e tyre. Nga autoriteti kontraktor në procesverbalin e hartimit të dokumentave është përcaktuar vetëm fakti që, specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga struktura e posaçme e ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, por pa dhënë asnjë argument për operatorët ekonomikë në lidhje me arsyet e AK-së për përcaktimin e këtyre parametrevë fikse dhe pa lejuar asnjë marzh me plus apo minus të këtyre parametrevë, brenda të cilave artikujt janë të pranueshëm nga autoriteti kontraktor.

Mos përcaktimi për prametrat e përmasave apo të peshës së kërkuar me marzhe të lejueshme, sjell kufizim të pjesmarrjes dhe orientim drejt artikujve të vecantë pra, drejt prodhuesve të vecantë. Kjo vjen në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Në nënin 36 “Specifikimet teknike” i Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar , parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjisllacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që prametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b”

të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me ?do mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet europiane?”

Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit në përcaktimin e specifikimeve në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe si rrjedhojë është në të drejtën e tij për të përcaktuar specifikime teknike në lidhje me artikujt e kërkuar të jenë përshkrime të sakta e të mos krijojnë konfuzion, apo pengesë për pjesëmarrje. Është detyrë e njërive përkatëse të mirëargumentojnë specifikimet teknike që do të prokurojnë, me qëllim që të jenë sa më të plota dhe të sakta. Në fazën e përgatitjes së dokumentacionit për prokurim të mallrave apo pajisje të ndryshme është e rëndësishme të përcaktohen parametrat për të dhënë informacion të plotë për artikujt objekt - prokurimi.

Në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë:

a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira;

b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: specifikim teknik nënkupton njërën nga sa vijon:

b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit.

Për gjithë sa më sipër kërkojmë që për të gjithë artikuj e përfshirë në këtë procedurë prokurimi të përcaktohet një marzh I lejuar në plus dhe në minus prej 5% si përsa I përket përmasave ashtu edhe për sa I përket peshës së kërkuar.

SË TRETË:

Kërkojmë saktësime në lidhje me produktet si më poshtë:

Për artikullin me numër rendor 3 (Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 33x25.5) me specifikimet teknike: “Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 33x25.5 cm me llape 10 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 3)”:

Per kete artikull keni publikuar skicen ku formati i kartonit sipas skices eshte 46 x 69 dhe keni

shkruar poshte skices qe dosja duhet te shtypet ne format jo me te vogel se 50 x 70 . Tek shtojca 5 Formulari i specifikimeve teknike keni kerkuar format 50 x 70. Tek skica llapa eshte 18cm, nderkohe tek shtojca 5 eshte 10cm. PERCAKTONI NE MENYRE TE QARTE FORMATIN DHE PERMASAT E KESAJ DOSJEJE.

Për artikullin me numër rendor 4 (Dosje te shtypura me Format 50x70, permasa 22x32), me specifikimet teknike: “Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 22x32 cm me llape 9 cm me dy llapa te palosura dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 4)”:

Per kete artikull keni publikuar skicen ku formati i kartonit sipas skices eshte 41 x 53 dhe keni shkruar poshte skices qe dosja duhet te shtypet ne format jo me te vogel se 60 x 40 . Tek shtojca 5 Formulari i specifikimeve teknike keni kerkuar format 50 x 70. PERCAKTONI NE MENYRE TE QARTE FORMATIN DHE PERMASAT E KESAJ DOSJEJE.

Për artikullin me numër rendor 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26) me specifikimet teknike: “ Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37xx26 – Kartoni të jetë 330 gr/m2, me 2 krahë, krahët të brendashkruar të palosura 20 cm, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura:

Për këtë artikull tek shtojca 5 keni kerkuar Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26 , nderkohe tek skica keni vendosur foto per Kutu per ruajtje te perhershme . Kjo foto nuk eshte e sakte. Publikoni foton e sakte per kete dosje.

SË KATËRTI:

Sikurse e cituam edhe më lart, procedura e prokurimit objekt I këtij ankimi, është pjesë e procedurës së prokurimit me objekt: “Shtypshkrime dhe materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a” e ndarë në dy lote, ku Loti i parë është me objekt: “Shtypshkrime për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave” dhe në të cilin janë përfshirë shtrypshkrime si: regjistra, libra, procesverbale, kartela, libreza, blloqe të ndryshëm, ndërsa në Lotin e dytë me objekt: “Materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a dhe bijave” janë përfshirë gjithshtu artikuj të cilët janë shtypshkrime si artikujt me numrat rendore si më poshtë:

- 5 (Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve);
- 6 (Regjister dhenie- marrje dokumentash);
- 9 (Formular dorezim materialesh ne arkive);
- 10 (Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave);
- 11 (Fletehyrje e perkohshme ne arkive);
- 13 (Fletepalosje A4);
- 14 (Fletepalosje 20x21);
- 15 (Postera 40x58);
- 16 (Postera 50x70)
- 17(Kutu per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18);
- 18 (Kutu per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9);
- 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26).

Përfshirja e artikujve të mësipërm në këtë procedurë prokurimi, ndërkohë që AK-ja shypshkrimet i

ka  rcaktur n  lotin e par  t  k saj procedure vjen n  kund rshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik

N  nenin 2 “Q llimi i ligjit “162/2021 “P r prokurimin publik” i ndryshuar ku p rcaktohet::
[?]”

Q llim i k tij ligji  sht :

- a) t  rris  efieenc n dhe efikasitetin n  procedurat e prokurimit publik;
- b) t  siguroj  mir p rdorim t  fondeve publike dhe t  ul  shpenzimet procedurale;
- c) t  nxis  pjes marrjen e operator ve ekonomik  n  procedurat e prokurimit publik;
-  ) t  nxis  konkurrenc n nd rmjet operator ve ekonomik ;
- d) t  siguroj  n  trajtim t  barabart  dhe jodiskriminues p r t  gjith  operator t ekonomik , pjes marr s n  procedurat e prokurimit publik;
- dh) t  siguroj  integritet, besim publik dhe transparenc  n  procedurat e prokurimit publik.[?]

N  nenin 39 i ligjit“162/2021 “P r prokurimin publik” i ndryshuar p rcaktohet::
[?]”

Autoriteti ose enti kontraktor mund t  vendos  t  jap  n  kontrat  n  form n e loteve t  ve anta, duke p rcaktuar madh sin  dhe objektin e k tyre loteve.

Autoriteti kontraktor, n  procedurat e prokurimit mbi kufirin e lart  monetar, n  rast se vendos t  zhvilloj  procedur n e prokurimit pa e ndar  n  lote, duhet t  parashikoj  n  p rcaktim t  arsyeve kryesore p r k t  vendim, i cili b het pjes  e dosjes s  tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet n  rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor p rcakton n  njoftimin e kontrat s, n  ftes n p r shprehje interesi ose kur thirrja p r konkurrim b het p rmes njoftimit p r ekzistenc n e n j sistemi kualifikimi, n  ftes n p r ofert  ose p r t  negociuar, n se ofertat mund t  dor zohen p r n j, p r disa ose p r t  gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund t  dor zohen p r disa ose t  gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund t  kufizoj  numrin e loteve q  mund t’i jepen n j ofertuesi, n se numri maksimal i loteve p r ofertues deklarohet n  njoftimin e kontrat s, n  ftes n p r shprehje interesi, n  ftes n p r ofert  ose n  ftes n p r t  negociuar.

Kur zbatimi i kriterave p r shpalljen e kontrat s fituese do t  b nte q  n j ofertues t  shpallej fitues i m  shum  loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor p rcakton n  dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat q  synojn  t  zbatojn  p r t  p rcaktuar lotet q  do t  jepen.

1. Kur t  n jtit ofertues mund t’i jepet m  shum  se n j lot, autoriteti ose enti kontraktor mund t  jap  kontrata q  kombinojn  disa ose t  gjitha lotet, pasi t  ken  specifikuar n  njoftimin e kontrat s ose n  ftes n p r shprehje interesi mund sin  p r ta b r  k t , dhe lotet ose grupet e loteve q  mund t  kombinohen.[?]

N  nenin 42, t  VKM nr.285, dat  19.05.2021, “P r miratimin e rregullave t  prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

[?] 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan n j kontrat  n  lote sa her  kjo  sht  e mundur. N   do rast, duhet t  p rcaktohet qart  madh sia dhe objekti i k tyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, n  procedurat e prokurimit mbi kufirin e lart  monetar, n  rast se vendos t  zhvilloj  procedur n e prokurimit pa e ndar  n  lote, duhet t  parashikoj  n  p rcaktim t  arsyeve kryesore p r k t  vendim, i cili b het pjes  e dosjes s  tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet n  rastin e kontratave sectorial. [?]

Ndarja e n j kontrate n  lote,  sht  n j vendim I r nd sish m q  autoriteti kontraktor merr gjat  procesit paraprak t  prokurimit, pasi ndikon drejtp rdrejt  n  nivelin e pjes marrjes s  operator ve

ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Ak-ja duhet të mbajë në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të paktë. Mosdarja e procedurës në lote duke pasur në konsideratë elementët e cituar më sipër, ul konkurrencën në radhët e operatorëve ekonomik, nuk e stimulon pjesmarrjen e biznesit të vogël.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor edhe pse ka shpallur një procedurë të ndarë në lote, në listën e produkteve të përcaktuara për prokurim në këtë procedurë prokurimi, përvec artikujve të cilaët janë të natyrës së artikujve të kancelarisë, si dosje, kuti, etiketa, të cilët janë të gatshëm dhe i tregëtojnë shoqëritë të cilët merren me tregëtimin e artikujve të tillë pra të fushës ë kancelarisë, ka përfshirë edhe shtypshkrime të cilat janë të një natyre tjetër nga ato të kancelarisë, duhe të prodhohen dhe se të tilla, realizohen nga operatorë ekonomikë të cilët janë të fushës së prodhimit, si shtypshkronjat.

Pra, përfshirja në këtë procedurë prokurimi e artikujve të natyrave të ndryshme për sa i përket operatorëve ekonomikë të cilët mund ti furnizojnë ato, pengon pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë të fushës së tregëtimit të artikujve të kancelarive edhe pse për një pjesë e konsiderueshme e artikujve janë në fushën e tyre të veprimtarisë dhe për këto artikuj mund të ofertojnë më cmime me konkurrese dhe favorizon në këtë mënyrë vetëm operatorët ekonomikë të cilët prodhojnë shtypshkrimet.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP edhe në disa vendime të saj ku janë trajtuar pretendime nga OE te ndryshëm në lidhje me përfshitjen e artikujve të natyrave të ndryshme në të njëjtën procedurë prokurimi, si psh në vendimin e KPP-së nr. Nr. 395/2024, datë 23.04.2024.

Për gjithë sa më sipër, kërkojmë të hiqen nga lista e artikujve për tu prokuruar në këtë procedurë prokurimi artikujt me numrat rendore si më poshtë:

- 5 (Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve);
- 6 (Regjister dhenie- marrje dokumentash);
- 9 (Formular dorezim materialesh ne arkive);
- 10 (Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave);
- 11 (Fletehyrje e perkohshme ne arkive);
- 13 (Fletepalosje A4);
- 14 (Fletepalosje 20x21);
- 15 (Postera 40x58);
- 16 (Postera 50x70)
- 17(Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18);
- 18 (Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9);
- 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26).

II- Në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.1 të shtojcës 7(FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT) të DT-së, në të cilin është kërkuar si më poshtë:

“...2.4.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit..”:

.....

ISO 16245 ose ekuivalent (per prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me baze celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma

Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë?.”, paraqesim kundërshtimet tona si më poshtë vijjnë:

Së pari:

Formulimi i autoritetit kontraktor që: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit..” duhet të ndryshojë pasi, shprehja certifikatë e vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit është e ekzagjeruar dhe krijon konfuzion si për operatorët ekonomikë ashtu edhe për KVO-në gjatë vlerësimit të ofertave, pasi certifikimet ISO, lëshohen për operatorët ekonomikë sipas fushave për të cilat janë certifikuar dhe në këto ISO nuk mund të shënohen formulimet sipas mënyrës së si autoritetet kontraktore përcaktojnë objektet e prokurimit rast pas rasti, por lëshohen sipas mënyrave të përcaktuara nga rregullat kombëtare apo ndërkombëtare për lëshimin e certifikimeve ISO, sipas fushave të veprimtarisë.

Për sa më sipër kërkojmë që formulimi ”...Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit..”, të ndryshojë dhe të jetë: ”...Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme në fushën e objektit të prokurimit..”.

Së dyti:

Në lidhje me kërkuesin e AK-së për praqitjen e ISO 16245 ose ekuivalent (per prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me baze celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi:

Kërkesa e Ak-së për praqitjen nga ofertuesi i ISO 16245 ose ekuivalent (per prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me baze celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve), nuk është e mirëargumentuar nga AK-ja dhe nuk është e lidhur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Në procesverbalin e hartimit të dokumentave AK-ja këtë kriter e ka argumentuar si më poshtë vijon:

“?Certifikimi me ISO 16245 eshte i nevojshem, kjo pasi verteton qe OE ofertues ne procesin e prodhimit respekton me rigorozitet dhe plotesonte gjitha masat e nevojshme per prodhimin e kutive dhe kapakeve te perbera nga material celuloze, te cilat perdoren per arkivimin e dokumenteve shkresore per nje periudhe te gjate kohe”

Objekt i prokurimit është blerje malli dhe jo prodhim. Kjo procedurë prokurimi është e kategorisë “mall” dhe jo “Shërbim”

Operatorët e ekonomikë të cilët pajisjen më këtë ISO me ISO16245 janë kompanitë e prodhimit të prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me baze celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve, pra shoqëritë të cilat duhet të prodhojnë artikujt me numrat rendore:

Nr.17(Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18); nr.18 (Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9) dhe nr.19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26), për të cilat ne kemi argumentuar dhe kërkuar më sipër në këtë ankesë që nuk duhet të prokurohen nga autoriteti kontraktor por, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në cilësinë e organit qendror blerës në zbatim të VKM-së 360 VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e DPA-së” e ndryshuar me VKM nr. 331, datë 22.05.2019.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se, nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri, nuk rezulton të jetë akredituar asnjë ka asnjë organ i vlerësimit të konformitetit, që të leshojë dhe të certifikojë kompanitë me ISO 16245 ose ekuivalent (per prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me baze celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve).

Në Nenin 79 (Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor) të ligjit Nr.162/2020 “për prokurimin public” i ndryshuar përcaktohet:

“?1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efijencës së energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit..”.

Në nenin 44 (Kërkesat e cilësisë) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” I ndryshuar, përcaktohet:

“...1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specififikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-së.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet t’ ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkon një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtën informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor...”

Për gjithë sa më sipër kërkojmë që të hiqet kriteri për kualifikim si më poshtë:

“...2.4.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit...”:

..... ISO 16245 ose ekuivalent (per prodhimin e kutive dhe te materialeve te tjera, me baze celuloze, per ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve) (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë?”

Së treti:

Në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.4 të shtojcës 7 të DT-së me përmbajtjen si më poshtë:

“...2.4.4. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë. Kjo të vërtetohet me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si edhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit...” , paraqesim kundërshtime tona si më poshtë vijojnë:

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“... 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

....

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës...”

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“...3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve...”

Në procesverbalin e hartimit të dokumentave, autoriteti kontraktor kriterin e mëipërm për kualifikim e ka argumentuar s më poshtë vijon:

“...Argumentim:Duke u nisur nga fakti se te gjithë artikujt e kerkuar kerkojne nje pregatitje paraprake te dizjanit nga nje specialist i familjarizuar me kerkesat qe nje material duhet te kete qe te quhet i gatshem per shtyp, kerkesa per nje specialist designer me diplome universitare eshte e nevojshme dhe mbi te gjitha qe te jete nje person qe gjithashtu ka specializim ne fushen e grafikes per shkak se pjesa me e madhe e artikujve kane te bejne me pergatitjen e formave per prerje. Standartet nderkombetare te prodhimit ne fushen e shtypshkrimeve apo marketingut kerkojne nje pune teper e sakte dhe duhet qe personi i cili kryen kete pune te jete nje specialist edhe ne fushen e pictures dhe ne ate te grafikes.

Kërkesa e AK-së që nëpër këtë procedurë prokurimi operatori ekonomik të ketë në stafin e tij një (një) dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë, vërtetuar me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si edhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit, është ekzagjeruar jo në proporcion me objektin e prokurimit pasi artikujt objekt prokurimi janë artikuj për të cilat OE-të nuk e kanë të domosdoshëm që të kenë në staf një dizjner, pasi janë artikuj të thjeshtë, një pjesë e tyre janë të gatshëm në treg dhe vetëm vendosja e logos së institucionit në to nuk justifikon kërkesën e AK-së që OE-të kenë një punonjës të diplomuar dhe të certifikuar në fushën e grafikës dhe dizajnit, pasi një proces të tillë mund të abëjnë shumë mire edhe punonjës të cilët nuk janë të specializuar në fushën e grafikës.

Kjo kërkesë e AK-së sjell kufizim të padrejtë të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë tregëtare, pasi dukshëm kjo kërkesë favorizon kompanitë prodhuese të fushë së shtypshkrimeve. Këtë objekt prokurimi mund ta realizojnë me sukses jo vetëm shtypshkronjat por edhe kompanitë tregëtare të cilat artikuj objekt i këtij prokurimi mund të porosisin dhe sigurojnë nga kompanitë prodhuese, nga

Shtypshkronjat si brenda dhe jashtë vendit.

Për gjithë sa më sipër kërkojmë që kriteri për kualifikim i përcaktuar në pikën 2.4.4 të shtojcës 7 të DT-së me përmbajtjen "...2.4.4. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë. Kjo të vërtetohet me diplomën e shkollës së lartë, kontratën e punës si edhe certifikatën përkatëse që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit...", të hiqet.

SË KATËRTI:

Në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikës 2.4.5 të shtojcës 7 të DT-së mepërmbajtjen si më poshtë:

"?2.4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

?Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me përmasa më të mëdha

?Makinë qepse me pe me permasa 35x25

?Makinë prerje me permasa 80x110

?Makine qepese me tel

?Thikë një anëshe

Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjetër të fitimit të pronësive sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjetër disponimi të njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqesin kontratën e qirase ose huapërdorjes të lidhur mes paleve, me afat kohezgjatje minimalisht dy muaj vlefshmeri, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjetër të fitimit të pronësive sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjetër disponimi të njohur nga ligji)...” e kundërshtojmë me argumentat si më poshtë:

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

”... 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me

objektin e kontratës.

....

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës...”

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“...3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve...”

Në procesverbalin e hartimit të dokumentave, autoriteti kontraktor kriterin e mëipërm për kualifikim e ka argumentuar s më poshtë vijon:

“...Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit me qëllim shpërndarjen e mallrave ne adresat e kerkuara ne DT. Duke analizuar te gjitha proceset e punes te cilet duhet te kryhen per prodhimin e materialeve te kerkuara nga AK, eshte llogaritur nje numer minimal makinerish posedimi i te cilave garanton qe OE ofertues ka kapacitetet teknike qe te kryeje punen e kerkuar...”

Sikurse e argumentuam edhe më sipër, kjo procedurë prokurimi është furnizim malli dhe jo shërbim.

Kriteret e veçanta për kualifikim të hartuara nga AK-ja, sikurse është edhe kriteri në fjalë, sjellin diskriminim e të gjithë operatorëve ekonomikë të cilët janë tregtarë të mallrave objekt prokurimi vetëm për faktin se ato nuk janë prodhuese direkte të tyre. Pra mënyra e hartimit të këtyre kriterëve sjellin në mënyrë automatike përjashtimin, ndalimin, pra diskriminim për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi e të gjithë operatorëve ekonomikë të cilët janë tregëtare dhe kjo ndalesë vjen në kundërshtim me ligjin e prokurimit public me qëllimet e këtij ligji sepse:

- a) ul eficientën dhe efikasitetin e kësaj procedure prokurimit public pasi ul konkurrencën, përjashton të gjithë OE-të tregëtare, ndërkohë që mund të jetë pikërisht kjo kategori e cila mund të ofertojë me produkte me cilësore dhe me cmime me konkuruese ;
- b) Nuk siguron mirëpërdorim të fondeve publike, pasi zvogëlon në mënyrë të paligjshme konkurrencën, pasi përjashton të gjithë OE-të tregëtare, ndërkohë që mund të jetë pikërisht kjo

kategori e cila mund të ofertojë me produkte me cilësore dhe me cmime me konkruuese, pasi kështë pikërisht kjo kategori e cila ka mund të bashkëpunojë me kompani të huaja prodhuese;

c) Nuk e nxit por përkundrazi ul pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi pasi, janë vendosur kritere të vecanta për kualifikim të cilat mund ti plotësojnë vetëm kompanitë prodhuese;

d) Sikurse e shpjeguar edhe më sipër, mënyra e hartimit të kritereve të vecanta për kualifikim nuk e nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, por e zvogëlon atë pasi mundëson vetëm pjesëmarrjen e prodhuesve dhe përjashton tregëtarët;

e) Pra në thelb, kriteret e përcaktuara në këtë procedurë prokurimi nuk sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, pasi diskriminon një kategori të gjerë të operatorëve ekonomike; Autoriteti kontraktor ka shkelur edhe një tjetër parim të ligjit 162/2020 e pikërisht atë të përcaktuar në pikën 2 të nenit 3 ku përcaktohet se, “ ? 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar?”

Pretendojmë se, mënyra se si AK apo të gjitha grupet e punës që mund të kenë marrë pjesë në hartimin e dokumentave të tenderit i kanë hartuar ato, sjell si pasojë ngushtimin e konkurrencës dhe rrjedhimisht favorizohen në mënyrë të padrejtë kompanitë e caktuara duke dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar e në rastin konkret janë operatorët ekonomike të cilët i marrin produktet nga kompanitë prodhuese Brenda dhe jashtë vendit dhe më pas i tregëtojnë ato”

Pse themi se, ky diskriminim dhe përjashtim nga pjesëmarrja në këtë procedurë prokurimi është i padrejtë dhe vjen në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit public. Po i argumentojmë edhe njëherë në mënyrë të përmbledhur.

Autoriteti kontraktor, për këtë objekt prokurimi ka shpallur procedurën e prokurimit nëpërmjet marrëveshjes kuadër, të kategorisë “MALL”, PRA “KONTRATË PUBLIKE PËR FURNIZIM” Pra, qëllimi i AK-së është të sigurojë, të blejë një mall të gatshëm që në rastin konkret janë kuti dhe dosje, etiketa, shtypshkrime etj.. Mallrat objekt prokurimi mund të sigurohen direkt nga prodhuesit e tyre por mund të sigurohen edhe nga shoqëritë tregëtare të cilat nuk janë vetë prodhuese të tyre por, bashkëpunojnë me kompani prodhuese vendase ose të huaja.

Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcakton në nenin 77 se:

“..1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës?”.

Në pikën 5 të nenit 40 (Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” përcaktohet: “?5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Pra, ligji dhe rregullat e publik në rastin e kontratës publike të kategorisë “Mall” përcaktojnë se, në varësi të objektit të prokurimit që në rastin konkret është blerje kuti dhe dosje, pra furnizim me mall, në varësi të natyrës së kompanisë nëse është prodhuese apo thjesht tregëtuese e mallit, AK-ja përcakton kriteret teknike në lidhje me stafin dhe mjetet dhe pajisjet teknike të cilat duhet të ketë në dispozicion ofertuesi.

Pra AK-ja nisur nga fakti se, qëllimin e saj për furnizimin me mallin objekt prokurimi sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK-ja, mund ta përmbushë me sukses si me kompanitë prodhuese ashtu edhe ato tregëtuese, duhet ti përcaktojë kriteret teknike dhe ato profesionale të ndryshme për rastin e një kompanie prodhuese dhe të ndryshme për rastin e kompanive të cilat janë tregëtuese të mallit.

Ajo që ka rëndësi për AK-në, janë përmbushja e specifikimeve teknike, pra furnizimi sipas cilësisë dhe standartit të kërkuar me cmimin me ulët të ofruar.

Janë kriteret të cilat duhet ti kërkohen kompanive të cilat deklarojnë se janë prodhuese të mallit objekt prokurimi, por jo kompanive të cilat deklarojnë se mallin objekt prokurimi nuk e prodhojnë vetë por e sigurojnë nga kompanitë prodhuese ose nga kompanitë e autorizuara nga prodhuesit. Përgjegjësinë për furnizimin e mallit objekt prokurimi sipas cilësisë së kërkuar në DT, e kanë njësoj si kompanitë prodhuese për mallit që ato vetë kanë prodhuar, ashtu edhe kompanitë tregëtuese të cilat furnizojmë mallrat e prodhuara nga kontraktorët e tyre, të cilët i kanë prodhuar këto mallra sipas kërkesës së kompanisë e cila do t'ja furnizojë mallin AK-së.

Shoqëria jonë ka marrë pjesë dhe ka realizuar me sukses shume procedura prokurimi ku kanë qënë të përfshira edhe artikujt të ngjashëm me artikujt objekt prokurimi si dosje, kuti, shtypshkrime të ndryshme, të realizuara si nga organi qendror blerës, Agjencia Shtetërore e Blerjeve të Përqendruara sot Operatori I Blerjeve të Përqendruara SHA ashtu edhe nga autoritete të tjera kontraktore të cilat nuk kanë pasur të përcaktuara kriteret në lidhje me makineri dhe pajisje apo kërkesa për staf me profil dizajner.

Këto kërkesa pamundësojnë edhe mbështetjen tek prodhues apo kompani të huaja pasi është shumë e vështirë të sigurosh dokumentacionin provues të kërkuar nga ana juaj për këto kriteret pra për makinerite dhe punonjës dizajner.

Më sipër në këtë ankesë ne kemi paraqitur kundërshtimet tona në lidhje me përfshirjen në këtë procedurë të artikujve me numrat rednore 17, 18 dhe 19 si dhe të shtypshkrimeve të tjera e konkretisht kemi kërkuar heqjen nga prokurimi në këtë procedurë, pra ndarjen në lot të vecantë të artikujve me numrat rednore si më poshtë:

5 (Flete procesverbal mbi dorezimin e të dhenave dhe materialeve);

6 (Regjister dhenie- marrje dokumentash);

9 (Formular dorezim materialesh ne arkive);

10 (Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave);

11 (Fletehyrje e perkohshme ne arkive);

13 (Fletepalosje A4);

14 (Fletepalosje 20x21);

- 15 (Postera 40x58);
- 16 (Postera 50x70)
- 17(Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18);
- 18 (Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x70x9);
- 19 (Dosje per ruajtje te perhershme me permasa 37x26).

Në rast të pranimit të ankesës tonë sa më sipër për më tepër kërkesa për makineritë e përcaktuara në pikën 2.4.5 të shtojcës 7 të DT-së, është jo në përputhje dhe jo në proporcion me objektin e prokurimit.

Për gjithë sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.5 të shtojcës 7 të DT-së me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“2.4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

?Makinë shtypi 50x70 5 C + llak ose me permasa më të mëdha

?Makinë qepse me pe me permasa 35x25

?Makinë prerje me permasa 80x110

?Makinë qepese me tel

?Thikë një anëshe

- Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.

- Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqese kontraten e qirase ose huaperdorjes te lidhur mes paleve, me afat kohezgjatje minimalisht dy muaj vlefshmeri, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji).

Per te permbushur kriterin e mesiperme ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklaroje disponimin e makinave ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST...”

SË PESTI:

Në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.7 të shtojcës 7 të DT-së me përmbajtjen si më poshtë:

“...2.4.7 Ne datën dhe orën e hapjes së tenderit duhet të paraqitet në cilësinë e mostres:

....Një Kuti per ruajtje te perhershme me permasa 40x28x18;...” paraqesim kundërshtimet tona si më poshtë vijojnë:

Së pari: kemi argumentuar dhe kërkuar që ky artikull të hiqet nga kjo procedurë prokurimi pasi AK-ja nuk është organi kompetent i caktuar nga ligji për të realizuar procedurat e prokurimit për këtë artikull për pasojë edhe mostra nuk duhet të kërkohej

Së dyti: referuar sasisë së kërkuar për këtë produkt i cili është vetëm 50 copë, një sasi shumë e vogël, kërkesa e AK-së për të paraqitur mostër është e ekzagjeruar pasi i sjell Operatorëve ekonomikë kosto të pajustificuara.

KPP në vendimet e saj ka mbajtur qëndrimin se AK-ja mund të kërkojë mostra për produktet të cilat janë kërkuar në sasi më të mëdha dhe në rastin konkret, ka shumë artikuj të tjerë për të cilët AK-ja mund të kishte kërkuar mostra pasi janë shumëfish i sasisë së kërkuar për këtë produkt dhe cuditërisht kërkohej mostër për një produkt për të cilin sasia e kërkuar është me e vogla se për të gjithë artikujt e tjerë.

Në përfundim kërkojmë të hiqet kërkesa për të paraqitur mostër për artikullin ”Kuti per ruajtje te

perhershme me permasa 40x28x18”.

Të nderuar,

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020, përcaktohet si vijon:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020, përcaktohet si vijon:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër sjellin mirëpërdorim të fondeve të autoritetit kontraktor, nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public, duke sjellë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

jo

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

hr@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani